



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

VENDIM

Nr. 2

Dt. 15 .01.2015

“PËR KONFIRMIMIN E RAPORTIT TË LLOGARITJES SË RRJEDHËS

EKOLOGJIKE TË “HEC ASHTA “ ”

Në mbështetje të Kreut V , nenit 39,” Përdorimi i burimeve ujore” të ligjit nr. 111/2012 datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore “ çdo përdorues i ujit është i detyruar që në rrjedhën natyrore të lejojë rrjedhjen minimale ekologjike, duke mos e përfshirë atë në sasinë e ujit që është i autorizuar të përdorë. Ajo nuk mund të jetë më e vogël se prurja me qëndrueshmëri 355 ditë në vit (Q355).

Bazuar në relacionin e paraqitur nga A.B.U. Drin - Bunë ,Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë :

VENDOSI :

1- Të miratojë kërkesën e subjektit “Energji ASHTA” me administrator **Z. Dietmar REINER** për konfirmimin e raportit të llogaritjes së rrjedhës ekologjike. Ky raport është në përputhje me kërkesat e ligjit nr.111/2012, lejes mjedisore dhe kërkesat e Kontratës së Konçesionit . Sipas këtij raporti rrjedha ekologjike është përlllogaritur në masën 15% të prurjes mesatare vjetore minimale.

**Q ekol = 11 m<sup>3</sup>/sek.** Kjo prurje mund të ndërpritet vetëm në rastin e ndalimit të plotë të punës të hidrocentralit të Vaut të Dejës.

2-Ngarkohet A.B.U. Drin- Bunë për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Sekretari

Kryetar

Martin PLLUMBI

Paulin RADOVANI



U mos ne dorozim  
Adrii Shkaban  
Dt. 22.01.2015

